

# Menaxhimi i lëndëve penale dhe orarit të gjykimeve

Tetor 2023



# **Menaxhimi i lëndëve penale dhe orarit të gjykimeve**

**Tetor 2023**



# 1. Hyrje

Që nga viti 1999, Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (në tekstin e mëtutjeshëm "OSBE") ka luajtur një rol kyç në monitorimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë në raport me pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare për gjykim të drejtë dhe të drejtat e njeriut. Monitorimi i gjykimeve realizohet nga personeli i OSBE-së në gjykatat në mbarë vendin dhe ka në fokus identifikimin e problematikave sistemore që prekin sistemin e drejtësisë.

OSBE është e shqetësuar se sistemi gjyqësor i Kosovës nuk po e ushtron në mënyrë adekuate autoritetin e tij në lidhje me përcaktimin e orarit të gjykimeve në lëmin penal. Sfidat në kuptim të ngarkesës me lëndë me të cilat përballen gjykatat themelore të Kosovës janë jashtëzakonisht të mëdha. Gjatë tre muajve të parë të vitit 2023, gjykatat themelore shqyrtuan gjithsej 46.852 lëndë penale: prej tyre 40.707 ishin lëndë të trashëguara dhe 6.145 lëndë të reja.<sup>1</sup> Megjithatë, deri në fund të periudhës tremujore të raportimit u zgjodhën vetëm 5,833 lëndë, kurse 41,019 ngelën si të pazgjidhura. Pavarësisht këtyre rrethanave, gjykatat<sup>2</sup> dështojnë rregullisht në mbajtjen e seancave të vazhdueshme deri në zgjidhjen e çështjes. Kjo praktikë e përkeqëson edhe më gjendjen me numrin e lëndëve të pazgjidhura të grumbulluara, përbën përdorim joefikas të burimeve të sistemit gjyqësor dhe përfundimisht krijon pengesë për drejtësinë.

Ky raport analizon çështjen e lëndëve penale të pazgjidhura të grumbulluara dhe vonesave përkatëse, problem ky i përhapur në Kosovë që ndikon negativisht në qasjen në drejtësi dhe në administrimin efikas të drejtësisë. Konkretisht, raporti fokusohet në mënyrën se si praktikat sistematike të menaxhimit të lëndëve penale në kuptim të caktimit të seancave të shqyrtimeve gjyqësore në harqe kohore të gjata çojnë në rritje të numrit të lëndëve të pazgjidhura penale. Raporti bazohet në monitorimin e drejtpërdrejtë nga ana e personelit të OSBE-së të seancave gjyqësore penale në vitin 2023. Ai ka si qëllim dhënien e rekomandimeve të zbatueshme për akterët përkatës të sistemit gjyqësor për të përmirësuar menaxhimin e lëndëve penale në fazën e gjykimit.

---

1 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, "Raport statistikor i tremujorit të parë 2023 mbi punën e gjykatave", faqe 10.

[https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/15988\\_KGJK\\_Raporti\\_statistikor\\_tremujorit\\_pare\\_2023\\_mbi\\_punen\\_gjykatave.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/15988_KGJK_Raporti_statistikor_tremujorit_pare_2023_mbi_punen_gjykatave.pdf) origjinali në gjuhën shqipe (qasur më 30 qershor 2023).

2 Megjithëse Kodi i procedurës penale i Kosovës parashihet që çështjet penale shqyrtohen nga gjyqtari i vetëm gjykues apo nga një trup gjykues me të cilin kryeson kryetari i trupit gjykues, për hir të koncizitetit dhe konsistencës, ky dokument do t'u referohet vetëm si veprime të ndërmarra nga "gjykata".

## 2. Metodologjia

Raporti bazohet në gjetjet nga monitorimi i gjykimeve i realizuar nga OSBE dhe mbështetet në kuadrin ligjor vendor dhe standardet ndërkombëtare të menaxhimit të lëndëve penale në lidhje me orarin e mbajtjes së seancave të shqyrtimeve gjyqësore. Ai ka në fokus identifikimin e problematikave sistemore të lidhura me caktimin e orarit të shqyrtimeve gjyqësore në mënyrë të ligjshme dhe efikase.

Gjetjet bazohen në vëzhgimin e drejtpërdrejtë të seancave nga ana e monitoruesve të OSBE-së dhe në aktgjykimet me shkrim për lëndë penale të botuara në vitin 2023. Këto të dhëna janë analizuar në raport me pajtueshmërinë me legjislacionin e Kosovës dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

### 3. Standardi ligjor

Si Kushtetuta e Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm “Kushtetuta”) ashtu dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtutjeshëm “KEDNJ”) e parashohin të drejtën e të akuzuarit për gjykim të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm. Kushtetuta u garanton personave të akuzuar për vepra penale të drejtën për liri dhe siguri personale (neni 29), si dhe të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm (neni 31). E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm garantohet edhe nga neni 6 i KEDNJ, dispozitë kjo e dizajnuar në shërbim të ngritjes së besimit të publikut në efektivitetin dhe besueshmërinë e sistemit gjyqësor dhe, në rastin e çështjeve penale, për të shmangur që personat e akuzuar për një vepër penale të qëndrojnë në situatë pasigurie për fatin e tyre për periudha të zgjatura.<sup>3</sup>

Kodi i procedurës penale i Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm “KPP”) e adreson në mënyrë taksative çështjen e kohëzgjatjes së shqyrtimit gjyqësor:<sup>4</sup> shqyrtimet gjyqësore që mbahen para gjyqtarit të vetëm gjykues duhet të përfundohen brenda 90 ditësh, kurse shqyrtimet gjyqësore që mbahen para trupit gjykues duhet të përfundohen brenda 120 ditësh.<sup>5</sup> Shqyrtimi gjyqësor mund të vazhdohet vetëm nëse gjykata nxjerr “aktvendim të arsyetuar” ku citohen rrethana urgjente të tilla si numri jashtëzakonisht i madh i dëshmitarëve, dëshmia e gjatë e dëshmitarit(ëve), numri jashtëzakonisht i madh i provave, ose për qëllime të sigurisë së shqyrtimit gjyqësor.<sup>6</sup> Gjykata mund ta vazhdojë shqyrtimin gjyqësor për 30 ditë për secilën nga këto rrethana.<sup>7</sup> Gjithashtu, gjykata mund ta shtyjë shqyrtimin gjyqësor kur konstaton se duhet mbledhur prova të reja ose kur gjatë shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se tek i akuzuari, pas kryerjes së veprës penale, është paraqitur çrregullim ose paaftësi mendore e përkohshme, ose kur ekzistojnë pengesa të tjera për zbatim të suksesshëm të shqyrtimit gjyqësor.<sup>8</sup>

Vetëm këto dispozita në tërësinë e tyre e lejojnë vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor për jo më pak se *shtatë herë* për arsye legjitime që kanë të bëjnë me menaxhimin e lëndës, pa llogaritur këtu dukurinë e shpeshtë të evidentuar nga monitoruesit e OSBE-së të mosparaqitjes së një a më shumë palëve në seancë, ose kur palët paraqiten mirëpo nuk janë të përgatitur për të proceduar. Nga ana tjetër, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (“KGJK”), duke njohur nevojën për mbajtje të seancave produktive dhe të vazhdueshme deri në zgjidhje të çështjes, ka nxjerrë udhëzime sipas të cilave gjykatat duhet mbajnë seanca të vazhdueshme deri në zgjidhje të

<sup>3</sup> *Dimitrov dhe Hamanov kundër Bullgarisë*, Aktgjykim i GJEDNJ-së i datës 10 maj 2011.

<sup>4</sup> *Shih përgjithësisht* nenin 5(1)(2) të KPP-së.

<sup>5</sup> *Po aty*, neni 310(1).

<sup>6</sup> *Po aty*, neni 310(2).

<sup>7</sup> *Po aty*, neni 310(3).

<sup>8</sup> *Po aty*, neni 306(1).

çështjes mes tjerash për lëndët për veprat penale dhunë në familje, lëndët penale që janë më të vjetra se dy vjet dhe për lëndët penale të kthyer në rigjykim.<sup>9</sup>

Vlen të theksohet se shumë shtete tjera kanë miratuar rregulla praktike për menaxhim të lëndëve sipas të cilave shqyrtimi gjyqësor duhet të zhvillohet në vazhdimësi dhe pa ndërprerje deri në zgjidhjen e çështjes. Për shembull, në Shqipëri, kur shqyrtimi gjyqësor nuk mund të përfundojë në një seancë të vetme, gjykata mund të vendos që të vazhdojë ditën e mëpastajme të punës; gjykata mund të ndërpresë shqyrtimin gjyqësor, vetëm për arsye të veçanta, deri në pesëmbëdhjetë ditë.<sup>10</sup> Maqedonia e Veriut ka paraparë që kur është e pamundur që shqyrtimi kryesor të përfundojë në një ditë të vetme, kryetari i trupit gjykues mund ta vazhdojë seancën në ditën e ardhshme të punës.<sup>11</sup> Kodi i procedurës penale i Italisë parasheh që kur nuk është e mundur që shqyrtimi gjyqësor të përfundojë në një seancë të vetme, ai duhet të vazhdojë ditën e radhës, me përjashtim të festave dhe fundjavave; seanca mund të vazhdojë “për një afat maksimal i cili, kur llogariten të gjitha vazhdimet, nuk i kalon dhjetë ditë” vetëm kur është absolutisht e domosdoshme.<sup>12</sup> Kodi i procedurës penale i Spanjës parasheh që pasi që shqyrtimi verbal të ketë filluar, i njëjti të vazhdojë pandërprerë “për të gjitha seancat e radhës që nevojiten për përfundimin e tij.”<sup>13</sup> Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, gjykatat shtetërore të Kalifornisë dhe Masaçusetsit kërkojnë caktimin e orarit të seancave “sa më afër ditëve të njëpasnjëshme për aq sa këtë gjë e lejon kalendari i gjyqtarit gjykues”<sup>14</sup> ose “fillimin e shqyrtimit gjyqësor pa vonesë në orën 9:30 në datën e planifikuar dhe vazhdimin e tij pa ndërprerje deri në përfundim.”<sup>15</sup> Këto rregulla të qarta për menaxhim të lëndëve sigurojnë që çështjet penale të shqyrtohen me shpejtësi dhe drejtësi.

---

9 Shtojca I e Planit strategjik të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për përmirësimin e qasjes në drejtësi 2022-2025 [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/2023/03/KJC\\_Strategic\\_Plan\\_on\\_Access\\_to\\_Justice\\_2022.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/2023/03/KJC_Strategic_Plan_on_Access_to_Justice_2022.pdf) (qasur më 30 qershor 2023).

10 Shqyrtimi gjyqësor – Rregulla të përgjithshme – Gjykimi i pandërprerë, neni 342 (1) dhe (2), Kodi i procedurës penale i Shqipërisë. [Kodi i Procedurës Penale-2017.pmd \(pp.gov.al\)](https://www.pp.gov.al/Kodi_i_Procedurës_Penale-2017.pmd) origjinali në gjuhën shqipe (qasur më 30 qershor 2023).

11 Neni 359 (1), Kodi i procedurës penale i Maqedonisë së Veriut. [https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2016/03/Zakon\\_za\\_Krivicna\\_postapka\\_150\\_18112010-2.pdf](https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2016/03/Zakon_za_Krivicna_postapka_150_18112010-2.pdf) origjinali në maqedonisht (qasur më 30 qershor 2023).

12 Vëllimi 7 – Gjykimi Titulli II – Seancat gjyqësore, Kreu 1 – Dispozita të përgjithshme, neni 477 – Kohëzgjatja dhe organizimi i shqyrtimit gjyqësor, Kodi i procedurës penale i Italisë. [https://www.gazzettaufficiale.it/dettaglio/codici/codiceProceduraPenale/465\\_0\\_1](https://www.gazzettaufficiale.it/dettaglio/codici/codiceProceduraPenale/465_0_1) origjinali në italisht (qasur më 30 qershor 2023).

13 Dekret mbretëror i 14 shtatorit 1882 me të cilin miratohet Ligji për procedurën penale, Titulli III, Kreu V – Pezullimi i shqyrtimit gjyqësor verbal, neni 744. <https://www.boe.es/buscar/act.php?id=BOE-A-1882-6036&p=20230629&tn=1#a744> origjinali në spanjisht (qasur më 30 qershor 2023).


14 Cal. R. Ct. 5.393. [https://www.courts.ca.gov/cms/rules/index.cfm?title=five&linkid=rule5\\_393](https://www.courts.ca.gov/cms/rules/index.cfm?title=five&linkid=rule5_393) (qasur më 30 qershor 2023).

15 ALM Dist. Ct. S.O. 6-83: Politikat e caktimit të orarit, vazhdimin dhe çështjeve tjera administrative. <https://www.mass.gov/districtmunicipal-court-rules/district-court-standing-order-6-83-scheduling-continuance-and-administrative-policies> (qasur më 30 qershor 2023).



## 4. Analiza e lëndëve

Përkundër udhëzimeve juridike vendore dhe ndërkombëtare, sistemi i drejtësisë penale i Kosovës vazhdon të përballë me vonesa të mëdha që, të paktën pjesërisht, janë rrjedhojë e menaxhimit joefikas të lëndëve në fazën e gjykimit. Për shembull, në një lëndë penale të proceduar në rajonin e Prizrenit, vepra penale e pretenduar ishte kryer më 21 nëntor 2016, ndërsa aktakuza ishte ngritur pas tre viteve më 25 nëntor 2019. Ndonëse shqyrtimi gjyqësor kishte nisur më 30 dhjetor 2019, gjykata vazhdoi me shqyrtimin e çështjes deri më 14 prill 2023, pra shumë përtej afatit kohor prej 120 ditësh të përcaktuar me KPP për shqyrtimet gjyqësore para trupit gjykues. Shpallja e aktgjykimit u bë më pas, më 19 prill 2023 (shih Grafikon 1 më poshtë).




### *Shembulli 1: Kronologjia e menaxhimit të lëndëve penale në rajonin e Prizrenit*

Në një procedurë për veprën penale dhunë në familje në rajonin e Prishtinës, gjyqtari e miratoi kërkesën e prokurorit për shtyrje në ditën e parë të shqyrtimit gjyqësor si rrjedhojë e mospërgatitjes së vetdeklaruar të tij, sepse zyra e tij nuk i kishte dhënë mbrojtjes informacionin e nevojshëm dhe pavarësisht faktit se një dëshmitar (i cili kishte bërë shpenzime udhëtimi për t'u paraqitur) e kishte të pamundur të paraqitej sërish në gjykatë në rast të shtyrjes. Në këtë rast, vepra penale ishte kryer më 06 qershor 2019, aktakuza ishte ngritur më 13 janar 2020, ndërkaq shqyrtimi gjyqësor nisi më 29 maj 2023, pra me një vonesë më shumë se trevjeçare dhe shumë përtej afatit kohor të përcaktuar me KPP.<sup>16</sup> Dita e dytë e shqyrtimit gjyqësor, njëherësh dhe seanca e parë produktive, nisi më 26 qershor


<sup>16</sup> Neni 249 i KPP-së

2023 por u shty sepse palët propozuan ndërprerje për pushim dreke e gjykata kishte seanca tjera të caktuara atë pasdite. Më 24 korrik 2023, pala e dëmtuar dha dëshminë se kishte qenë subjekt i ngacmimit, kanosjes dhe përndjekjes nga ana e të pandehurit. Marrja në pyetje nuk vazhdoi atë pasdite meqë prokurorja tha se ishte në kujdestari dhe se kishte obligime tjera. Seanca e radhës u caktua më datën 7 shtator 2023 (shih Grafikun 2 më poshtë).




**Shembulli 2:** Kronologjia e menaxhimit të lëndëve penale në rajonin e Prishtinës

Në një lëndë për vjedhje të proceduar në rajonin e Pejës, vepra penale e pretenduar kishte ndodhur më 11 gusht 2018, ndërkaq aktakuza ishte ngritur më 28 shtator 2018. Mirëpo, seanca e parë fillestare u mbajt tek katër vjet më pas, më 18 dhjetor 2022, me ç’ rast gjyqtari e pranoi deklarin e të pandehurit si të pafajshëm dhe i dha kohë për t’i përgatitur dhe paraqitur kundërshtimet e tij ndaj aktakuzës. Seanca e radhës ishte caktuar të mbahej më 12 janar 2023, mirëpo, përkundër thirrjes së bërë gojarisht në seancën paraprake, as i pandehuri dhe as pala e dëmtuar nuk u paraqitën dhe as nuk e arsyetuan mosparaqitjen. Gjykata e hodhi më pas poshtë aktakuzën më 2 shkurt 2023, duke u thirrur në një marrëveshje ndërmjetësimi të arritur ndërmjet palëve (shih Grafikun 3 më poshtë). Vlen të ceket se aktvendimi për hudhje të aktakuzës nuk u arsyetua me analizë nëse lënda i përmbush kushtet për procedim në procedurë ndërmjetësimi.




**Shembulli 3:** Kronologjia e menaxhimit të lëndëve penale në rajonin e Pejës

Një trup gjykues nga rajoni i Gjakovës kryesoi me shqyrtimin gjyqësor të një lënde penale që kishte të bënte me abuzimin seksual të një të mituri: vepra e pretenduar kishte ndodhur më 27 janar 2021, aktakuza ishte ngritur më 29 qershor 2021, mirëpo trupi gjykues nuk e filloi shqyrtimin gjyqësor deri në 31 janar 2023, me ç’ rast u paraqitën provat në formë të dëshmisë së dëshmitarit. Në datën e seancës së radhës, 21 shkurt 2023, një ekspert dëshmoi dhe dorëzoi një raport me shkrim dhe u paraqitën fjalët përfundimtare.



**Shembulli 4:** Kronologjia e menaxhimit të lëndëve penale në rajonin e Gjakovës

Në një lëndë për veprën penale sulm seksual ndaj një të mituri në rajonin e Ferizajt, vepra penale e pretenduar kishte ndodhur më 19 dhjetor 2022, ndërsa aktakuza ishte ngritur më 12 shkurt 2023. Seanca e parë produktive u zhvillua më 31 mars 2023, me ç’ rast i pandehuri u deklarua i pafajshëm dhe shqyrtimi gjyqësor nisi me dëshminë dhe marrjen e tërthortë në pyetje të palës së dëmtuar. Seanca e radhës u mbajt më 20 prill 2023, gati tre javë më vonë, me ç’ rast i pandehuri u dëgjua dhe iu parashtruan pyetje të tërthorta, dhe nuk u paraqit asnjë provë tjetër. Gjykata miratoi propozimin e prokurorit për shtyrje të shqyrtimit si rrjedhojë e mospërgatitjes së tij për të paraqitur fjalën përfundimtare. Gjykata vazhdoi me ditën e tretë të gjykimit më 27 prill 2023 me ç’ rast palët i paraqitën argumentet përfundimtare. Gjyqtari e shtyu shqyrtimin deri më 2 maj 2023, ku edhe e shpalli vendimin e tij. Si përfundim, u deshën 32 ditë për mbajtjen e një shqyrtimi gjyqësor katërditor, periudhë kjo brenda afatit kohor nëntëdhjetëditësh të KPP-së por që megjithatë përbën menaxhim joefikas të kohës e të resurseve (shih Grafikon 5 më poshtë).



**Shembulli 5:** Kronologjia e menaxhimit të lëndëve penale në rajonin e Ferizajt

## 5. Përfundimet

Kur një gjykim shtyhet, por nuk i jepet epilogu, si gjykata ashtu edhe përfaqësuesit e palëve vazhdojnë me trajtimin e lëndëve tjera, ku secilës lipset t'i kushtohet kohë. Inercioni mund të avancojë dhe ta kaplojë kalendarin e gjykimeve, duke paralizuar kështu përparimin e autoriteteve gjyqësore. Për ta maksimizuar ekonomizimin e proceseve gjyqësore dhe kujtesën e palëve dhe dëshmitarëve, për të minimizuar kohën dhe shpenzimet e udhëtimit të dëshmitarëve dhe për të rritur shkallën e paraqitjes së palëve dhe dëshmitarëve, shqyrtimet gjyqësore dy-treditore, në vend se të shtyhen dhe të ndahen në dy-tre seanca në hark kohor të po aq muajve, duhet të zhvillohen pa ndërprerje brenda dy-tre ditësh.

## 6. Rekomandime

Duke u mbështetur në çështjet e shtjelluara më sipër, OSBE rekomandon sa vijon në funksion të përmirësimit të efikasitetit në menaxhimin e lëndëve penale në Kosovë:

### **Për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës:**

- Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës duhet të marrin parasysh krijimin e një sistemi të brendshëm të përcjelljes së lëndëve (ose modifikimin e sistemit ekzistues për menaxhim të lëndëve) për t'i identifikuar vonesat e shumta e të pajustificueshme dhe korrelacionet e mundshme me gjyqtarë apo prokurorë të caktuar, për t'i realizuar vlerësimet e performancës në mënyrë adekuate.

### **Për gjykatat themelore:**

- Gjykatat duhet të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar respektimin e udhëzimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për caktimin e seancave të pandërprera dhe të vazhdueshme për (të paktën) lëndët për veprat penale dhunë në familje, lëndët për veprat penale që janë më të vjetra se dy vjet, lëndët penale të kthyera për rigjykim, si dhe situatat tjera të parapara me Planin strategjik 2022-2025.

- Të realizojnë kontrole të cilësisë për të gjitha llojet e sipërpërmendur të lëndëve, për të identifikuar se për cilat lëndë penale, nëse procedohen në gjykim, duhet të caktohen seanca të vazhdueshme deri në zgjidhjen e çështjes.
- Gjyqtarët duhet t'i përdorin në plotni kompetencat e tyre sanksionuese, t'i verifikojnë gjithnjë arsyet e vonesës ose mosparaqitjes së palëve dhe, po të jetë e nevojshme, t'i zbatojnë masat ndëshkuese dhe disiplinore të shqiptimit të gjobave monetare ose masat tjera ligjore të parapara me KPP<sup>17</sup>. Mosaplikimi i sanksioneve të mirëfillta për mosrespektim të rregullave të gjykatës, përfshirë thirrjet për t'u paraqitur në seancë, është në dëm të menaxhimit efektiv të gjyimit. Palët që paraqiten para gjykatës duhet ta dinë se do të jenë subjekt i sanksioneve përkatëse nëse me sjelljen e tyre të gabuar ndërhyjnë në administrimin e drejtësisë.

### **Për prokurorinë, mbrojtjen dhe përfaqësuesit e autorizuar:**

- Të ripohojnë se gjithë ata që ofrojnë përfaqësim ligjor duhet të sillen me kujdes dhe profesionalizëm gjatë mbrojtjes së interesave të qeverisë ose të klientëve të tyre. Avokatët dhe përfaqësuesit e tjerë të autorizuar duhet t'i menaxhojnë kalendarët e tyre gjyqësor për të siguruar paraqitjen me kohë, shmangien e kërkesave për shtyrje dhe mungesat e paarsyeshme. Gjykatat duhet të njoftohen paraprakisht me arsyetime të mirëqena për çdo shtyrje ose mungesë, dhe t'u jepen sugjerime për data alternative të të dakorduara paraprakisht nga të gjitha palët në procedurë.

### **Për Akademinë e Drejtësisë:**

- Të ofrojë trajnime për gjyqtarët në lidhje me procedurat e administrimit efikas të gjykatave sipas KPP-së dhe Planit strategjik të Këshillit Gjyqësor të Kosovës 2022-2025.

---

<sup>17</sup> Neni 65 i KPP-së e autorizon gjykatën që t'i shqiptojë gjobë deri në 1000 Euro mbrojtësit, të dëmtuarit ose viktimës, mbrojtësit të viktimave ose përfaqësuesit të viktimës për zvarritje të procedurës, si dhe e obligon gjykatën që ta njoftojë Odën e Avokatëve të Kosovës për shqiptimin e gjobës ndaj një anëtari të saj. Kur vonesa të tilla shkaktohen nga prokurori, gjykata duhet ta njoftojë kryeprokurorin e prokurorisë përkatëse.



